



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 49,50 dhe 51 të Ligjit Nr. 2004/15 për Ndërtim, nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave kalimtare, neni 24 të Udhëzimit Administrativ të MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-89225/20 dt. 11.06.2020, investitorit Refik Havolli, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për shtëpi banimi me afarizëm me etazhitet B+P+2, e ndërtuar në Lagjen “Kodra e Trimave” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 08.02.2021 lëshon këtë:

V E N D I M
LEJE E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Leja e përdorimit pronarit/investitorit Refik Havolli nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr.351/04-89225/20 dt. 11.06.2020, për përdorimin e ndërtesës shtëpi banimi me afarizëm, me etazhitet B+P+2, e ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale nr.10374-0 (si rezultat i bashkimit të parcelave 213-16 dhe 213-17), Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Kodra e Trimave”, sipas Vendimit numër 05 Nr. 351-8228 dt. 12.05.2010 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-8228 dt. 12.05.2010, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës.

III. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Leje Përdorimi shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Refik Havolli nga Prishtina, më kërkesën me 05 Nr. 351/04-89225/20 dt. 11.06.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e Lejes së përdorimit për përdorimin e ndërtesës shtëpi banimi me afarizëm, me etazhitet B+P+2, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Aktvendimin nr. 05 Nr. 351-8228 dt. 12.05.2010 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shtëpi banimi me afarizëm me etazhitet B+P+2 të pronarit Refik Havolli nga Prishtina, në kuadër të ngastrës kadastrale nr.10374-0 (si rezultat i bashkimit të parcelave 213-16 dhe 213-17), Zona Kadastrale Prishtinë, Lagjja “Kodra e Trimave” në rrugën “Ndue Përllëshi” .
- Aktvendimin nr. 05 Nr. 351-8228 dt. 19.04.2010 mbi kompensimin për rregullimin e tokës ndërtimore të pronarit Refik Havolli nga Prishtina

- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të ndërtesës nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit me numër 05-351/04-44297/20 të datës 27.02.2019.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht raportin e komisionit profesional të pranimit teknik të ndërtesës dhe të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e investitorit, ka konstatuar se:

Ndërtesa banimore është ndërtuar në pajtim me Vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionit tjetër teknik dhe se i njëjti i përmbush normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të ndërtesave të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtorja e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës t'a lëshoj Lejen e Përdorimit.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Leje Përdorimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Leje Përdorimi, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/02-89225/20 DT. 08.02.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:

Mimoza Berisha Prestreshi



Drejtori:

Ardian Olluri

